



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 17 maj, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Pjetër Shalës, duke konstatuar se vazhdon të ekzistojë rreziku se z. Shala mund të pengojë ecurinë e procedurave penale dhe të kryejë vepra penale të tjera. Trupi Gjykses vendosi gjithashtu se vetëm në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara mund të kryhet mbikëqyrja e efektshme e komunikimeve të akuzuarit. Trupi Gjykses rikujtoi se të gjithë dëshmitarët e thirrur nga Prokuroria kanë dhënë dëshmi dhe se janë paraqitur prova shtesë të cilat mund të jenë inkriminuese. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vendosi se ekzistonte rreziku se z. Shala mund t'i realizojë kërcënimet e bëra më parë, veçanërisht duke pasur parasysh atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë. Duke qenë se gjykimi po përparon pa vonesa të papërligjura, Trupi Gjykses konstatoi se koha që i akuzuari ka kaluar në paraburgim vazhdon të jetë e arsyeshme.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, më 16 maj, Trupi Gjykses miratoi redaktimet e sugjeruara nga Prokuroria, Mbrojtësi i Viktimave dhe Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve për transkriptet e versioneve publike me më pak redaktimeve të katër dëshmitarëve të cilët dhanë dëshmi nga fundi i vitit të kaluar. Trupi Gjykses urdhëroi gjithashtu që disa pjesë shtesë të transkriptit të riklasifikohen si publike. Ky proces është pjesë e rishikimit periodikisht të transkripteve dhe parashtrimeve për të garantuar që proceset të jenë sa më publike.

Pas një urdhri të lëshuar nga Trupi Gjykses më 21 shkurt, Prokuroria dorëzoi një "njoftim për ndryshim të dëshmitarëve" për ta thjeshtuar listën e dëshmitarëve të saj. Sipas parashtrimit, Prokuroria nuk synon më të mbështetet në dëshmitë e 10 dëshmitarëve dhe do të kërkojë leje për të parashtruar me shkrim dëshmitë e 13 dëshmitarëve, në vend se t'i thërrasë të japin dëshmi në sallë të gjyqit. Prokuroria konfirmoi se do të vazhdojë të rishikojë rregullisht listën e dëshmitarëve dhe bëri me dije se ata do të mund të japin një njoftim për ndryshime shtesë në tetor të këtij viti.

Më 22 maj, Trupi Gjykses pranoi si prova pesë deklarata të dëshmitarëve dhe dy deklarata të dëshmitarëve, pjesërisht. Konkretisht, Trupi Gjykses konstatoi se prova materiale të caktuara që lidhen me dy deklarata nuk janë të përshtatshme për t'u pranuar si prova.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, të martën më 21 maj, dëshmitari i 63-të i thirrur nga Prokuroria, z. Ditrih Klaus-Jensch (Dietrich Klaus-Jensch) dha dëshmi në gjyq publikisht. Sipas përmbledhjes së paraqitur nga Prokuroria, z. Klaus-Jensch shërbeu si oficer në KFOR-in gjerman në Prizren gjatë periudhës përkatëse. Më të njëjtën ditë, dëshmitari i 64-t, Johan Rudolf-Friç (Johan Rudolph Fritsch) filloi dhënien e dëshmisë, po ashtu në seancë publike. Dëshmitari ishte zëdhënës shtypi në KFOR-in gjerman në Prizren gjatë periudhës përkatëse.





Pasi dëshmitari i 64-t përfundoi dje dhënien e dëshmisë, Prokuroria thirri një dëshmitar të mbrojtur. Sipas përmbledhjes që lexoi Prokuroria, dëshmitari është i afërm i një viktime të pretenduar të zhdukjes me forcë dhe vrasjes së paligjshme në Drenoc.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për nesër, të premten, 24 maj, dhe fillon në orën 9:00 paradite.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

